

		RÉPUBLIQUE DE KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVË / REPUBLIC OF KOSOVO	
		AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	<u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.	<u>01-4853/15</u>
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages	<u>02</u>	Data Datum Date	<u>18.12.2015</u>
PRISHTINE			



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 18.12.2015, mori:

### V E N D I M

**I. Mbylllet rasti me nr. AKK-03-02-3971/15, për zyrtarin e lartë z. Lumni Kryeziu, Këshilltar Komunal në Komunën e Malishevës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të mundshëm të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-3971/15,që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Lumni Kryeziu, Këshilltar Komunal në Komunën e Malishevës.**

Gjatë procesit për identifikimin e rasteve të dyshuara për konfliktit të mundshëm të interesit, është identifikuar rasti për zyrtarin e lartë z. Lumni Kryeziu, Këshilltar Komunal në Komunën e Malishevës.

Gjatë kontrollit është vërejtur se zyrtari i lartë ka të regjistruar një biznese privat dhe figuron si person i autorizuar në këtë biznes e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 13.11.2015, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Lumni Kryeziu, ka ardhur në zyrat e AKK-së ku nga zyrtaret kompetent të ngarkuar me rastin është njoftuar me faktet dhe provat që posedon AKK-ja

Zyrtari i lartë z. Lumni Kryeziu, Këshilltar Komunal në Komunën e Malishevës, është pajtuar me gjendjen por është arsyetuar se nuk ka pas njohuri lidhur me situatën e konfliktit të interesit por është zotuar se brenda afatit ligjor do të bej ndryshimet dhe do të veproj sipas ligjit ne fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Me datën 11.12.2015, kemi pranuar dokumentet zyrtare nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Lumni Kryeziu, nuk figuron me si person i autorizuar ne biznesin “INFINIT KONTO”SH.P.K me numër 70946629 .

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarrë nga zyrtari i lartë z. Lumni Kryeziu, Këshilltar Komunal në Komunën e Malishevës, duke ber ndryshimet ne biznesin privat, dhe duke hequr dorë nga ushtrimi i pozitës se personit të autorizuar në biznesin e tij, janë krijuar rrëthana të reja dhe konstatojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrëthana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari kontaktues )

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit  
Hasan Preteni

